V E N D I M
Nr.306, datë 21.6.1993

PËR ORGANIZIMIN E SISTEMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe organet e pushtetit lokal, organizon e drejton sistemin e formimit profesional në Republikën e Shqipërisë me qëllim integrimin e fuqisë punëtore në ekonominë e tregut, rritjen e aftësive e të nivelit të saj profesional dhe uljen e shkallës së papunësisë nëpërmjet kualifikimit, rikualifikimit e specializimit në kurse kualifikimi, qendra të formimit profesional dhe qendra inkubatore të biznesit të vogël.

2. Për organizimin dhe drejtimin e këtij sistemi, Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe organet e pushtetit lokal:

a) Kryen studime dhe përgatit e zbaton projekte për sistemin e formimit profesional.

b) Së bashku me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, organizon kurse kualifikimi, qendra të formimit profesional, qendra inkubatore të biznesit të vogël dhe forma të tjera të formimit profesional.

c) Përcakton strukturën organizative dhe personelin e nevojshëm për funksionimin e sistemit të formimit profesional.

3. Shpenzimet për organizimin dhe funksionimin e këtij sistemi përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi